

V E N D I M
Nr.10, datë 11.5.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 12.12.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.47/6 Akti që i përket:

KËRKUES: FESTIM HOXHA, përfaqësuar nga avokat Koçi Mato, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I QARKUT ELBASAN, në mungesë.

2.KËSHILLI I KOMUNËS QUKËS, LIBRAZH, përfaqësuar nga juristja Thëllëza Shebeku, me autorizim.

3. ISMAIL KRYEZIU

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.168, datë 27.01.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Shkaqet të cilat, sipas kërkesit, e bëjnë vendimin të papajtueshëm me Kushtetutën janë:

1. Gjykata e Lartë ka pushuar çështjen me argumentin se mosmarrëveshja, objekt gjykimi, nuk hyn në rrethin e çështjeve që shqyrtohen nga gjykata dhe se çështja hyn në juridiksionin administrativ.

2. Ky qëndrim i Gjykatës bie ndesh me kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës për të drejtën që ka çdo individ për t’iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, si dhe me përmbajtjen e neneve 324 e 325 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Në rastin konkret, janë ezauruar mundësitë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes në rrugë administrative.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në zgjedhjet lokale të 12 tetorit të vitit 2003, kërkuesi është zgjedhur anëtar i Këshillit të Komunës Qukës, Librazhd, si përfaqësues i subjektit politik, Balli Kombëtar.

Në bazë të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në datë 04.11.2003, bëhet konstituimi i këshillit të komunës, ku u procedua edhe për zgjedhjen e dy anëtarëve për në Këshillin e Qarkut Elbasan. Nga votimi i parë kërkuesi arriti të marrë votat e nevojshme për t’u zgjedhur anëtar i këshillit të qarkut, por drejtuesit e mbledhjes organizuan një votim tjetër, nga i cili doli fitues subjekti i interesuar, Ismail Kryeziu.

Kundër vendimit të këshillit të komunës, kërkuesi është ankuar pranë Prefektit të Qarkut

Elbasan, nga i cili ka marrë përgjigje negative. Pas kësaj, ai i drejtohet gjykatës së rrethit duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të këshillit të komunës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.26, datë 14.01.2004, ka vendosur pranimin e padisë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.219, datë 21.04.2004. Mbi rekursin e personit të interesuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin objekt kërkesë, prish dy vendimet e gjykatave dhe e pushon çështjen me arsyetimin se “mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk hyn në rrethin e çështjeve që shqyrtohen nga gjykata, prandaj çështja hyn në juridiksionin administrativ”.

Gjykata Kushtetuese çmon se përfundimi në të cilin ka arritur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke e nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, i mohon individit të drejtën për akses në gjykatë, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Arsyetimi që bën Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendim, se mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk hyn në rrethin e çështjeve që shqyrtohen nga gjykata, bie në kundërshtim me nenet 324 e 325 të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se në kompetencë të seksioneve për gjykimet administrative është “padia me të cilën kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i një akti administrativ” dhe se padia mund të ngrihet “kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cenohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive”.

Padia e ngritur nga kërkuesi është në përputhje të plotë me kërkesat e këtyre dispozitave dhe si e tillë është pranuar për gjykim dhe është shqyrtuar nga dy shkallët e gjykimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arsyeton në vendim se të dyja gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, pasi ai nuk përcakton gjykatën si organ kompetent për zgjidhjen e konflikteve që lindin gjatë kryerjes së procedurave të votimit për mandatet e këshilltarëve.

Gjykata Kushtetuese çmon se mospërmendja shprehimisht, nga dispozitat e ligjit ku referohet Kolegji Civil, e kompetencës së gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla, nuk përlligj nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, përderisa dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nuk e ndalojnë që çështje të tilla hyjnë në juridiksionin gjyqësor.

Nga ana tjetër, ky Kolegj shprehet se çështja hyn në juridiksionin administrativ, ndërkohë që ligji për qeverisjen vendore nuk ka përcaktuar se cili organ është kompetent për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të tillë dhe as procedurën përkatëse.

E drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t’u drejtuar me padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen, në bazë të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Qëllimi është që ndaj veprimeve të pushtetit administrativ që prekin të drejtat e individit, duhet të ushtrohet një kontroll, i cili nuk mund të jetë tjetër veçse kontroll gjyqësor. “Shteti ligjor presupozon, ndër të tjera, që një ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv që normalisht i përket gjyqësorit, i cili ofron garantimin më të mirë të pavarësisë, paanësisë dhe procesit të rregullt”.¹

Në ushtrimin e kontrollit kushtetues për çështje të kësaj natyre, Gjykata Kushtetuese mban parasysh edhe faktin se ligji përcakton edhe rastet kur nuk mund të bëhet ankim në gjykatë ndaj një akti administrativ, por rasti i kërkuesit nuk inkadrohet në asnjë nga këto aspekte përjashtimore të ligjit, që t’i jepte të drejtë gjykatës ta nxirrte çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij, nuk përcakton dhe as nuk nënkupton përjashtime të tilla, por shprehet në mënyrë të thjeshtëzuar dhe të pakonkretizuar se kërkuesi nuk ka zbatuar kërkesat ligjore, pasi ai duhej ta mbronte këtë të drejtë në rrugë administrative.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se në rrethanat e paraqitura, çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ishte i detyruar të shprehej në lidhje me shkaqet e pretenduara në rekurs, duke bërë të mundur realizimin e një të drejte të ligjshme të

¹ Çështja Klass, dt.06.09.1978, Setria A. nr.28, fq.25-26.

kërkuesit. Detyrimet kushtetuese e ligjore lidhur me të drejtën e individëve për t'u ankuar në gjykatë, kundër akteve e veprimeve administrative, kanë për qëllim kontrollin e këtyre të fundit në funksion të respektimit të të drejtave e lirive të njeriut dhe realizimit të drejtësisë. Organet administrative, edhe pse shqyrtojnë e zgjidhin mosmarrëveshje sipas kompetencave që u janë dhënë, ato nuk mund të quhen organe që japin drejtësinë, pasi një funksion i tillë u përket vetëm gjykatave.

Juridiksioni gjyqësor në një shtet të së drejtës, nëpërmjet kontrollit të ligjshmërisë së akteve administrative, luan një rol të dukshëm e të rëndësishëm në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, është e padrejtë dhe ka prekur standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e mohimit të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, pra të përjashtimit të vetë procesit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe në nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.168, datë 27.01.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.